



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

---

Numri i lëndës: 2021:235165

Datë: 25.01.2023

Numri i dokumentit: 03900962

P.nr. 262/2021

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË, me Gjyqtaren Sabrije Rraci dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lirridona Palushi, në çështjen penale kundër të pandehurit A (U) G nga fsh. S K. Klinë, i akuzuar për veprën penale, Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, me PP/II.nr. 1806/2021 të datës 19.10.2021, e në pajtim me nenin 253 par.1, pika 1.3 dhe par.2, të të KPPRK-së, jashtë seancës gjyqësore, me datën 25.01.2023 muar këtë:

A K T V E N D I M

I.HUDHET – Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë, me PP/II.nr. 1806/2021 të datës 19.10.2021, ndaj të pandehurit A G, i akuzuar për veprën Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 të KPRK-së,

II.PUSHOHET: procedura penale ndaj të pandehurit A G, për shkak të Vdekjes.

III.SHPENZIMET – e procedurës penale bien në barrë të mjeteve bugetore të kësaj Gjykate.

A R S Y E T I M

Pranë kësaj gjykate Prokuroria Themelore Pejë ka ngritur Aktakuzë me PP/II.nr. 1806/2021 të datës 19.10.2021, kundër të pandehurit, A (U) G nga fsh. S K. Klinë, i akuzuar për veprën

penale, Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së –si, dhe pushohet procedura penale ndaj tij për shkak të Vdekjes.

Bazuar në shkresat e lëndes sipas Aktakuzës PP/II 1806/2021, të dt. 19.10.2021 për veprën penale vjedhje e shërbimeve, nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, e cila është kryer me datën 22.10.2020, kurse është pranuar në gjykatë me datën 20.10.2021.

Gjykata është njoftuar nga zyrtaret e stacionit policor në Klinë, se A G i lindur me dt. .. identifikuar me nr. personal .. , ka vdekur me dt.04.08.2022, ku dhe gjykata është pajisur me dëshminë - Certifikatën e Vdekjes me nr. Serik .. e cila certifikatë është lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës me dt. 23.01.2023, e cila certifikatë është nxjerrë nga Kuvendi Komunal Klinë- Zyra e Gjendjes Civile, e cila dëshmi 0 bashkëngjitet shkresave të lëndës.

Andaj duke u bazuar në këtë rrethanë se i pandehuri A G ka vdekur gjykata ka pushuar procedurën dhe ka nxjerr Aktvendim refuzues.

Gjykata duke u bazuar ne nenin 358 pika 1.3 dhe paragrafi 2 të KPPRK-së në të cilin thuhet se “Aktvendimi mbi hudhjen e aktakuzës mund ta merr gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues, edhe jashtë seancës gjyqësore.

**GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË**  
P.nr. 262/2021 më datën 25.01.2023

Zyrtare Ligjore  
Lirridona Palushi

G j y q t a r j a:  
Sabrije Rraci

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kunder këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit, e përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2021:235165  
Datë: 25.01.2023  
Numri i dokumentit: 03900962